



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 800 Prot.

Tiranë, më 21 . 05 . 2025

V E N D I M

Nr. 128, datë 21 . 05 . 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën me nr. 225 Regj., datë 05.11.2024, të paraqitur nga z. P. H, kundër Entit Rregullator të Energjisë (ERE-s) dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh a), në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti ankues, pranë KMD-së, si dhe parashtrimet e tij, në mes të tjerash, citohet se:

“Në objektin ku unë jetoj e banoj prej 27 vitesh, kam një Kontratë Familjare për furnizim me energji elektrike. Mirëpo për kushtet e reja që mu krijuan, kërkoja furnizim me energji elektrike

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri ose me akronimin KMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

³ Mungesa e titullit të pronësisë së banesës së tij, kërkimin e së cilës, ankuesi po e ndjek gjyqësisht për privatizimin e objektit dhe çështja është në process gjyqësor.

për Kontratë Jofamiljare, për biznes, kërkesë që daton më 19.09.2022, me nr. serie L 120220919665, Instanca KNK 4 Tiranë.

OSSH sha, me shkresën me nr. 2668 prot., datë 26.03.2024 (kthim përgjigje pas 1.5 viteve) shprehet se: “...në momentin e përfundimit të procesit gjyqësor dhe me pajisjen tuaj me dokument të vlefshëm pronësie, mund të aplikoni pranë Zyrrave të Kujdesit të Klientit OSSH sha, për të aplikuar për Lidhje të Re ne objektin tuaj”.

Në këto kushte, OSSH sha, më ka hequr të drejtën për furnizim me energji elektrike, për shkaqe të paligjshme, me pretendimin e “mungesës së titullit të pronësisë në atë objekt”, që unë kam kërkuar dhe kam në posedim prej 27 vitesh, edhe pse në po këtë objekt unë kam kontratë për furnizim me energji elektrike, për konsumator familjar, dhe kam po ashtu kontratë furnizimi me ujë, për Kontratë Familjare dhe Jofamiljare.

Kushti për titull pronësie është i parashikuar në Vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, të ndryshuar, dhe shprehet në pjesën e II-të: “Dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një Lidhjeje të Re në TU2.1 Fuqia e instaluar 0-20 Kë.

...OSSH sha ka ndjekur politika agresive ndaj meje, për faktin se, në objekt është instaluar matësi, nisur nga kërkesa ime për Lidhje të Re, por nuk futet në sistem, çka përbën një “grackë” për mua, për faktin se, nëse unë do të marr energji elektrike, kjo gjë do të shërbente si shkak që Furnizuesi të mund të hapte një proces penal ndaj meje, për marrje të energjisë elektrike në mënyrë të paligjshme. Ky matës i energjisë elektrike, për të cilin do të ishte Kontrata e Lidhjes së Re, ekziston edhe sot i montuar, fiksuar e vulosur nga OSSH sha-3G, i gatshëm për të furnizuar objektin, në pritje për t’u aktivizuar.

Sa më sipër, pretendimi i ngritur nga OSSH sha, se për lidhjen e kësaj kontrate shërbimi duhet patur një titull pronësie, është i pabazuar, për faktin se unë jam në një proces gjyqësor lidhur me objektin për të cilin kam kërkuar Lidhje të Re, e për më tepër kur, në të njëjtën kohë, unë kam Kontratë Familjare për furnizimin me energji elektrike për përdorim familjar, po ashtu dhe kontratë për furnizimin me ujë, për konsum familjarë dhe jofamiljarë.

Nga pikëpamja logjike, sipas Furnizuesit, në kushtet e sotme të reformës në drejtësi, lidhja e re edhe nëse nuk vonon nga ana e Furnizuesit, ndërkohë që aktualisht unë jam 74 vjeç, dhe gjykimi ende nuk ka përfundur në Gjykatën Administrative, prej dy vitesh dhe kundërshtimi nga palët është i ligjshëm dhe i mundur, i takon që çështja e një lidhjeje të re, mbi atë ekzistuese familjare e për të njëjtin objekt, të mos realizohet sa të jem unë në jetë- e paimagjinueshme.

Objekti që unë po kërkoj për një lidhje të re, ka qenë më parë me kontratë jofamiljare, kur për rrethana personale mu desh ta ktheja nga Jofamiljare në Familjare. Sot kur mua më duhet të riaktivizoj aktivitetin privat, nga ana e Furnizuesit më vihen kushte, gjë që aktualisht jam pa energji elektrike në objektin ku ushtroj aktivitetin privat.

Nga ana ime janë vënë në dispozicion të OSSH sha dhe ERE-s, të gjitha dokumentet e kërkuara përkatëse, duke përfshirë edhe vërtetimin nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, sipas së cilës konfirmohet fakti se, pranë kësaj Gjykate është regjistruar çështja me nr. 31138-07326-80-2022, datë 16.12.2022, me objekt detyrimin e të paditurit, të vazhdojë procesin e privatizimit të objektit të ish-Zyrave të SMT Burrel (objekt ku unë kërkoj Lidhjen e Re, për Kontratë Jofamiljare, kur prej 25 vitesh kam Kontratë Faamiljare për energjinë elektrike).

Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, çdo qytetar ka të drejtë të përfitojë nga shërbimet e domosdoshme për një standard të përshtatshëm jetese dhe shëndeti. Mungesa e energjisë elektrike ka sjellë pasojë të rënda për mirëqenien dhe aktivitetin tim ekonomik, duke më privuar nga gëzimi i një të drejte themelore. Ky trajtim përbën një shkelje të qartë të së drejtës time për mosdiskriminim dhe mbrojtje të standardit të jetesës.”

Përfundimisht, subjekti ankues pretendon se furnizuesi i energjisë elektrike OSSH sha, përmes një vendimi të pajustificuar dhe të pabazuar në ligj, nuk realizon furnizimin me energji elektrike, duke kërkuar si kusht posedimin e titullit të pronësisë për objektin, edhe pse ekziston një kontratë furnizimi me energji elektrike dhe uji, prej më shumë se 27 vitesh.

Ai citon, ndër të tjera, se: “Ky veprim jo vetëm që shkel dispozitat ligjore për të drejtën e furnizimit me energji elektrike si një shërbim thelbësor, por gjithashtu përbën një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues ndaj meje si përdorues, duke u bazuar në mungesën e titullit të pronësisë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndalimin e diskriminimit ndaj tij për shkakun e pretenduar, si dhe marrjen e masave për lidhjen e kontratës “Lidhje e Re Jofamiljare”.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të

njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1513/2 prot., datë 18.11.2024, Komisioneri, ka kërkuar nga ERE dhe OSSHEE sh a, informacionin dhe dokumentacionin si vijon:
 - *“Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e subjektit ankues për diskriminim për shkak të mungesës së titullit të pronësisë, klasifikuar si “çdo shkak tjetër”, sipas LMD-së.*
 - *Kopje të praktikës së mbajtur lidhur me trajtimin e ankesave të z. H.*
 - *Kopje të Kontratës Familjare të furnizimit me energji të z. P. H, dhe parashtrime nga ana juaj, se përse i refuzohet kërkesa për Lidhje të Re të Kontratës Jofamiljare.*
 - *Cilat janë kushtet e kërkuara për Lidhjet e Reja të Kontratës Familjare dhe Jofamiljare?*
 - *Ku ndryshojnë kërkesat që duhet të plotësojë një abonent për Lidhje të Kontratës Familjare nga ajo Jofamiljare? (Aktet ligjore apo nënligjore ku rregullohet një parashikim i tillë)*
 - *Në dijeninë tuaj, a keni patur raste të tilla të ngjashme me kërkesën e z. H (për Lidhje të Re Jofamiljare) të trajtuara nga ana juaj, si janë trajtuar/zgjidhur? Kopje të praktikave të mbajtura me subjektet kërkuar.*
 - *Cila është praktika dhe politika që ndiqet nga ana e juaj, lidhur me kërkesat për Lidhje të Reja Familjare ose Jofamiljare (kur kërkuar i mungon titulli i pronësisë)? Cilat janë masat e ndërmarra nga ana juaj për zgjidhjen apo adresimin e problematikave të tilla, kur kërkuar nuk posedojnë tituj pronësie – në kushtet e informalitetit të objekteve (familjare ose jo) njohur nga të gjitha instancat shtetërore? Kopje të akteve përkatëse.*
 - *Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.”.*
- Me shkresën nr. 967/10 prot., datë 27.11.2024, ERE, ka informuar Komisionerin, duke cituar ndër të tjera, se:

“.... Referuar rrethanave të provuara qoftë nga z. H, por edhe të kuadrit ligjor në fuqi, vlerësojmë se z. H nuk i është nënshtruar asnjërës nga format e njohura në ligj të diskriminimit, sa i përket kërkesës për të realizuar një lidhje të re në mungesë të titullit të pronësisë.

Që të justifikohet ligjërisht, kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur. Në kuptim të jurisprudencës, z. H, në kushtet e ekzistencës së një hetimi gjyqësor me qëllim përcaktimin e titullit të pronësisë mbi objektin, objekt privatizimi, për të patur legjitimitet aktiv duhet më parë të lejojë Gjykatën të shprehet me vendim përfundimtar, pa paragjykuar vendimmarrjen e saj, qoftë përse i përket pranimi tërësisht të padisë, por edhe të përcaktimit të kufijve të pronësisë së objektit që kërkon të privatizohet. Në një arsyetim analog, përjashtimi i detyrimit të dokumentimit të lidhjes ligjore me objektin e furnizueshëm, nga aplikuesi për një lidhje të re me rrjetin kombëtar të shpërndarjes, do të ekspozonte jo vetëm OSSH sha, por edhe vetë rrjetin ndaj aksesit të padokumentuar të çdo pale që vërteton dhe vetëm ekzistencën e një hetimi gjyqësor me objekt detyrimin e organit shtetëror për të privatizuar një objekt në shfrytëzim (edhe të paligjshëm) apo dhe çdo palë tjetër që është në procesin e përfitimit gjyqësor të titullit të pronësisë mbi një pronë.

Sa i përket pyetjes nëpërmjet së cilës, kërkonti t’ju përcjellim praktikën e mbajtur për konsumatorin z. P. H, bashkëlidhur shkresës gjeni kopjen e praktikës së mbajtur në ERE, me qëllim shqyrtimin e ankesës së tij.

Sa i përket pyetjes tuaj nëse ERE, ka pasur praktika të ngjashme me kërkesën e z. H, ju sqarojmë se, ERE, trajton ankesat e konsumatorëve të energjisë elektrike të cilat si parakusht kanë që, pala e interesuar të ngrejë e mbështesë një pretendim të ligjshëm ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licensuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e ligjit të sektorit apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike.

...lidhur me kërkesat për lidhje të re, ju bëjmë me dije se, OSSH sha, në zbatim të legjislacionit në fuqi, shqyrton e vlerëson aplikimet për lidhjet e reja, e po mbi përgjegjësinë e ngarkuar në cilësinë e operatorit të rrejtit, miraton apo refuzon çdo aplikim që plotëson apo nuk plotëson kriteret e miratuara në këto akte ligjore e nënligjore në fuqi.

Lidhur me pyetjen se cilat janë masat e ndërmarra nga ERE për zgjidhjen dhe adresimin e problematikave të tilla, ju bëjmë me dije se ERE, trajton ankesat e konsumatorëve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e duke vlerësuar kërkesat e konsumatorëve, me qëllim garantimin e transparencës mbi baza jodiskriminuese.

Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, në nenin 27, pika 3 e tij, parashikon se ERE miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i

licensuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe efëçente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.

Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit. Siç evidentohet më sipër, pronësia si një element thelbësor i identifikimit të vetë lidhjes mes përdoruesit të rrjetit dhe objektit të furnizuar, është prekuizitë e ligjit, e jo vetëm e akteve të miratuara në zbatim të tij

Lidhur me pyetjen për masat e ndërmarra nga ERE kur konsumatorët nuk posedojnë titull pronësie, ju bëjmë me dije se, në Rregulloren e Lidhjeve të Reja, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar, në pjesën e II, përcaktohet dokumentacioni i nevojshëm që aplikanti duhet të ketë për të aplikuar për një lidhje të re, me rrjetin e shpërndarjes në të cilën, për të provuar lidhjen ligjore të aplikuesit me objektin që synohet të furnizohet, kërkohet vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si: akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacionit përkatës për objektet që janë në proces legalizimi. Garantimi i dokumentimit të lidhjes mes objektit që kërkohet të furnizohet dhe titullarit potencial të lidhjes së re, jo vetëm është një kërkesë e ligjit, por edhe sepse, për vetë specifikat e sektorit të energjisë, shmang rrezikun shumë të madh me të cilin mund të ekspozohet rrjeti dhe operatori përgjegjës, nëse të njëjtat kushte, kur konsumatorët që nuk posedojnë një titull pronësie kërkojnë të lidhen me rrjetin për të njëjtin objekt.”

- Me shkresën nr. 12855/2 prot., datë 10.12.2024, OSSH sha, ka informuar Komisionerin, duke cituar ndër të tjera, se:

“Z. P. H ka paraqitur pranë qendrës së Kujdesit ndaj Klientit kërkesën për realizimin e lidhjes së re në sistemin e shpërndarjes së kategorisë “Fuqia e instaluar 0-20 kë”.

Për realizimin e lidhjes së re duhet të depozitohet dokumentacioni përkatës referuar Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, miratuar nga Bordi i komisionerëve të ERE-s, me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar.

Me depozitimin e kërkesës, strukturat përgjegjëse të shoqërisë OSSH sha, vlerësojnë nëse dokumentacioni plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në këtë rregullore, për vazhdimin e procedurës në terren duke kryer montimin e bazës materiale të nevojshme për këtë lidhje.

Në rastin e z. H, është konstatuar mungesë e dokumentit të pronësisë, i cili është dokument bazë për realizimin e lidhjes së re. Për këtë fakt, është njoftuar ankuesi duke i kërkuar të plotësojë mangësitë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së kërkuar.

Bazuar në ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe akteve rregullore të miratuara nga ERE, lidhja e re në rrjetin e shpërndarjes kërkon dorëzimin e dokumentacionit që provon pronësinë ose të drejtën ligjore mbi objektin që kërkon të furnizohet. Kjo kërkesë është e domosdoshme për sigurimin e qartësisë ligjore në lidhje me objektin e furnizimit, parandalimin e situatave konfliktuale për të njëjtin objekt nga palë të ndryshme dhe ruajtjen e sigurisë dhe funksionalitetit të rrjetit të shpërndarjes.

OSSH sha, ka zbatuar dhe zbaton kërkesat e ligjit dhe të akteve nënligjore, të cilat përcaktojnë qartë dokumentacionin e nevojshëm për lidhjet e reja. Kërkesa për një vërtetim pronësie apo dokument tjetër të barazvlefshëm është një standard i miratuar në Rregulloren e Lidhjeve të Reja, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, i ndryshuar.

Dokumentacioni i munguar nuk është plotësuar nga z. H, pasi ka depozituar vetëm një vërtetim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, për procesin gjyqësor me Agjencinë e Kadastrës për njohjen e pronësisë së truallit dhe objektit për të cilin pretendohet se duhet të realizohet lidhja e re.

Me datë 06.03.2024, z. H ka paraqitur ankesë me shkrim pranë Shoqërisë tonë, ku shpjegon se ka matës të instaluar në objekt dhe mungon vetëm lidhja me sistemin e shpërndarjes dhe duke qenë se procesi gjyqësor për njohjen e pronësisë së truallit dhe objektit po vazhdon në gjykatën kompetente, kërkon realizimin e lidhjes së re, pa patur dokumentin e pronësisë.

Kësaj kërkesë i është kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës me nr. 2668/1 prot., datë 26.03.2024, të OSSH sha. Ankuesi është njoftuar se, me pajisjen e tij me dokument të vlefshëm pronësie, siç përcaktohet në aktet nënligjore të miratuara nga ERE, dhe që zbatohen nga OSSH sha, mund të aplikojë pranë zyrave të Kujdesit ndaj Klientit të OSSH sha, për Lidhje të Re në objektin e tij.

...kërkesa për dokumentacion që vërteton lidhjen ligjore të aplikuesit me objektin që synon të furnizohet me energji elektrike nuk përbën diskriminim, por është një kërkesë e përligjur dhe e arsyeshme për të mbrojtur interesat e rrjetit të shpërndarjes dhe të palëve të treta të përfshira.

...duke qenë se Shoqëria OSSH sha, shqyrton çdo aplikim për lidhje të re me rrjetin, në mënyrë të barabartë dhe transparente, duke respektuar dispozitat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, të ndryshuar dhe rregulloret përkatëse të miratuara nga ERE, ashtu siç shqyrtohen të gjitha kërkesat e paraqitura nga e gjithë Republika e Shqipërisë, pretendimi për diskriminim të personit për shkakun e pretenduar, nuk qëndron dhe për këtë arsye kërkojmë konstatimin e mosdiskriminimit nga ana e OSSH sha, në rastin e ankesës së z. P. H”.

2. Në respektim të parimit të barazisë së armëve dhe procesit të drejtë administrativ, prashtrimet dhe dokumentacioni i depozituar pranë Komisionerit nga ERE dhe OSSH sha, i është përcjellë për njohje nëpërmjet e-mailit datë 23.12.2024, edhe subjektit ankues.

3. Subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit datë 06.01.2025, ka depozituar observacione lidhur me parashtrimet e ERE-s dhe OSSH sha, sa i takon problematikës së tij, duke i qëndruar pretendimeve të ankesës së tij, duke theksuar ndër të tjera, se:

“... jam posedues i objektit prej më shumë se 25 vitesh dhe trashëgimtar i truallit ku ndodhet objekti. Objekti është në proces privatizimi, bazuar në vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, i cili e njeh pronën si pjesë të trashëgimisë sime ligjore. Lidhur me këtë fakt kam administruar dhe një vertetim me të cilin provohet se jam në proces gjyqësor lidhur me privatizimin e objektit, objekt i këtij ankimimi.

Kam pasur një kontratë të mëparshme për furnizim me energji elektrike si konsumator familjar, dhe vazhdoj ta kem. Më vonë, si përdorues i objektit për qëllime jofamiljare, aplikova për një lidhje të re për fuqi deri në 6 kw. Furnizuesi OSSH sha, ka realizuar instalimin e matësit tre fazor, vulosur dhe i gatshëm nga ana ime për të marrë energji elektrike, fakt të cilën nga ana ime e kam quajtur si “grackë”, për faktin e mos hedhjes të të dhënave të matësit në Bill System nga ana e OSSH sha, i cili ka pasur për qëllim, hapjen e një padie penale, për marrje të energjisë në mënyrë të paligjshme.

Kam plotësuar e dorëzuar të gjithë dokumentacionin sipas akteve nënëligjore në fuqi. Pas një periudhe 18 mujore, kërkesës sime iu dha një përgjigje negative, me argumentin e mungesës së titullit të pronësisë.

Rregullorja e Lidhjeve të Reja të OSSH sha, parashikon lidhjen e energjisë elektrike edhe për ata që janë në proces legalizimi të objekteve. Procesi im i privatizimit ka të njëjtën logjikë ligjore si procesi i legalizimit, pasi, jam posedues faktik dhe i ligjshëm i objektit dhe kam paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme për një kontratë energjie.

Refuzimi i lidhjes së re, pavarësisht se kam plotësuar të gjitha kriteret shkel të drejtën time bazë për akses në energjinë elektrike.

Refuzimi i lidhjes së re ka ndikuar drejtpërdrejtë në aftësinë time për të zhvilluar aktivitet ekonomik në ambientet e mia, duke më shkaktuar humbje të tërthorta të të ardhurave financiare, kufizim të të drejtës për shfrytëzim të pronës, si dhe përkeqësim të situatës financiare familjare dhe sociale.”

4. Në vijim të procedurës hetimore, për një gjykim sa të drejtë të kësaj çështjeje dhe për të zhvilluar një proces të drejtë ligjor, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 241 prot., datë 03.02.2025, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore.

Palëve iu është bërë e ditur, se gjatë seancës kanë të drejtë të depozitojnë në cilësi prove çdo informacion plotësues ose akt administrativ, të cilin ende nuk e kanë paraqitur pranë KMD-së dhe që vlerësojnë se ka rëndësi për përcaktimin e gjendjes së fakteve e rrethanave të çështjes.

Seanca dëgjimore u zhvillua datën 18.02.2025, me pjesëmarrjen e subjektit ankues, z. P. H, ERE-s, përfaqësuar nga znj. J. G, me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Çështjeve Konsumatore dhe znj. A. M, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Mbikëqyrjes së Standardeve të Cilësisë⁴, pranë ERE-s, si dhe OSSH sh a, përfaqësuar nga z. A. A, me detyrë Jurist, pranë shoqërisë “OSHEE Group” sh a⁵.

Gjatë seancës dëgjimore, palët në proces mbajtën të njëjtin qëndrim si ai i bërë i njohur para KMD-së shkresërisht, si dhe parashtruan të njëjtat argumente, të cilat do të shtjellohen edhe në vijim të këtij Vendimi.

- Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet e-mailit palëve iu vu në dispozicion për njohje procesverbali i mbajtur si dhe kopje e audios së saj, duke u bërë të ditur, që nëse do kishin observacione t’i parqisnin para KMD-së deri me datë 10.03.2025.
- Nëpërmjet shkresës me nr. 949/2 prot., datë 07.03.2025, ERE, depozitoi pranë KMD-së parashtrime shtesë, duke sqaruar ndër të tjera, se:

“ ERE edhe në shkresat e mëparshme ka dhënë sqarime referuar rrethanave të provuara qoftë nga z. H, por edhe kuadri ligjor në fuqi, se z. H nuk i është nënshtruar asnjërës nga format e diskriminimit sa i përket kërkesës për të realizuar një lidhje të re në mungesë të titullit të pronësisë. Gjithashtu ERE, dha shpjegime lidhur me përjashtimin e detyrimit të dokumentimit të lidhjes ligjore me objektin e furnizueshëm, nga aplikuesi për një lidhje të re me rrjetin kombëtar të shpërndarjes, duke argumentuar se një precedent i tillë do të ekspozonte jo vetëm OSSH sha, por edhe vetë rrjetin ndaj aksesit të padokumentuar të çdo pale që vërteton qoftë edhe vetëm ekzistencën e një hetimi gjyqësor me objekt detyrimin e organit shtetëror për të filluar procesin e privatizimit të një objekti në shfrytëzim (edhe të paligjshëm) apo dhe çdo pale tjetër që është në procesin e përfitimit gjyqësisht të titullit të pronësisë mbi një pronë.

Në vijim të shkresës sipërcituar ERE u njoftua për zhvillimin e një seance dëgjimore nga Komisioneri, me anë të shkresës me nr. 949 prot., datë 05.02.2025.

Gjatë zhvillimit të seancës u diskutuan çështjet lidhur me këtë problematikë e gjithashtu u ngrit pretendimi për moszbatim të procedurave nga ana e ERE-s, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga konsumatori P. H.

ERE gjatë kësaj seance dëgjimore, argumentoi gjithashtu se pikërisht vërtetimi i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, për zhvillimin e një hetimi gjyqësor që si objekt ka pikërisht – “fillimin e procesit të privatizimit nga institucioni përgjegjës”, krijon bindjen e plotë se z. H jo vetëm që nuk është në proces privatizimi, por as gjykata nuk ka marrë ende një vendim të formës së prerë, nëse ky i fundit plotëson kriteret ligjore për t’ju pranuar ose jo padia e ngritur pranë gjykatës.

⁴ Sipas delegimit nëpërmjet emailit të Sekretarit të Përgjithshëm të ERE-s, z. E.B.

⁵ Sipas Autorizimeve me: nr. 1682 prot., datë 17.02.2025, të OSSH sh a dhe nr. 754 prot., datë 17.02.2025, të FSHU sh a.

ERE dëshmoi pozicionin e saj, si një institucion i pavarur e që në asnjë rast nuk pranon të marrë rolin e gjykatës, për të paragjykuar qëndrimin e kësaj të fundit në lidhje me objektin e padisë, por ashtu siç dhe është shprehur në korrespondencat e shumta me z. H, vetëm pas vërtetimit nga ky i fundit se gëzon statusin e të qenit në proces legalizimi apo privatizimi, e duke plotësuar kështu kriteret e përcaktuara në ligj dhe në rregulloren e miratuar nga ERE, mund të aplikojë për lidhje të re në rrjetin e shpërndarjes.

...

Në konkluzion, kërkojmë mbylljen e hetimit administrativ me objekt diskriminimin e z. H nga ana e OSSH sha dhe ERE-s, duke konsideruar absolutisht të paqenësishme, të paprovuara e të pambështetura në legjislacionin në fuqi, pretendimet e z. H.

Kërkojmë rrëzimin e kërkesës së z. H për njohjen e diskriminimit për shkakun e pretenduar, duke vlerësuar se kërkesa e tij për trajtim të ndryshëm nga parashikimet e nenit 27, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energhise Elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Rregulloren e Lidhjeve të Reja në Rrjetin e Shpërndarjes”, të miratuar nga ERE, në zbatim të ligjit sipërcituar, do të vendoste në kushte diskriminuese çdo konsumator tjetër që ka dokumentuar me çdo veprim administrativ të nevojshëm, statusin e të qenit në proces legalizimi/privatizimi”.

Sa i përket aspekteve procedurale të trajtimit të kërkesave të konsumatorit për shqyrtimin administrativ të ankesës së z. H, ERE, ka cituar kronologjikisht korrespondencën shkresore të mbajtur me z. H.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të subjektit ankues.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat, rrethanat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar, si dhe në analizë të legjislacionit specifik.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues, z. P. H, me datë 19.09.2022, ka paraqitur një kërkesë për lidhje të re, për furnizim me energji elektrike, për fuqinë 6 Kw (kërkesa me nr. serie L120220919665 - 2022). Nëpërmjet shkresës me nr. 2668/1 prot., datë 26.03.2024, (pas rreth 18 muajsh nga aplikimi, kërkesa e paraqitur prej tij) OSSH sha, ka refuzuar kërkesën e subjektit ankues, për shkak të mungesës së dokumentit të vlefshëm të pronësisë, për objektin ku kërkohet të realizohet lidhja e re.

Ndërkaq, rezulton e provuar dhe pranuar nga palët, se, subjekti ankues posedon qetësisht dhe në mirëbesim objektin në fjalë prej 27 vitesh tashmë, dhe se, banesa e tij furnizohet me energji elektrike nga OSSH sha, sipas kontratës si abonent, konsumator familjar.

Po ashtu, për të njëjtin objekt të ankuesit, ndodhur në të njëjtat kushte, në vitet e mëparshme (*fakt i pakundërshtuar nga ERE dhe OSSH sha*) në emër të bashkëshortes së tij (M. H) është nënshkruar një kontratë e lidhur mes palëve për furnizimin me energji elektrike për abonent jofamiljar (biznes privat), e cila më pas është ndryshuar në kontratë për furnizim me energji elektrike për abonent familjar. (*provuar nga pagesat e energjisë elektrike, realizuara nga subjekti*)

Lidhur me sa më sipër, Enti Rregullator i Energjisë Elektrike dhe OSSH sha, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim dhe kanë refuzuar kërkesën e ankuesit për lidhjen me kontratë për furnizimin me energji elektrike duke arsyetuar se: “...*kërkuesi që aplikon për lidhje të re, duhet të paraqesë këto dokumenta: Vërtetim të pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si: Akt shitjeje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacionin përkatës për objektet që janë në proces legalizimi.*”

Në këtë refuzim, ERE dhe OSSH sha, janë bazuar në parimet e Rregullores së Lidhjeve të Reja në Sistemin e Shpërndarjes, pjesa e II, pika 2.1.

Edhe në parashtrimet e ERE-s dhe OSSH sha, por edhe në deklaratimet në seancën dëgjimore, përveçse është konfirmuar arsyetimi i mësipërm, është nënvizuar se:

“Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat e detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.”

Siç evidentohet më sipër, pronësia si element thelbësor i identifikimit të vetë lidhjes mes përdoruesit të rrjetit dhe objektit të furnizuar, është prekuizitë e vetë ligjit, e jo vetëm e akteve të miratuara në zbatim të tij.

Komisioneri vlerëson se, arsyet për refuzimin e lidhjes së energjisë elektrike për kontarën jofamiljar, ndaj ankuesit, janë rrjedhojë e një kuptimi dhe interpretimi të ngushtë të “*Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes*”.

Ankuesi ka pretenduar se objektin, për të cilin kërkon kontratën me furnizim me energji elektrike, e ka në posedim në kushtet e mirëbesimit, prej 27 vitesh, dhe se, për këtë objekt ka pasur e vazhdon të ketë kontratë për furnizim me energji elektrike si konsumator familjar, dhe se, ka aplikuar për lidhje energjie po mbi të njëjtin objekt, më saktë mbi një pjesë të këtij objekti, me kontratë për furnizim me energji elektrike si abonent jo familjar.

Komisioneri vëren se, nëse ankuesit i është lidhur kontratë për furnizimin me energji elektrike si abonent familjar (prej 27 vitesh), kontratë që vazhdon dhe sot, pa disponuar aktin e pronësisë apo përdorimit, sipas përcaktimit të Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes,

pjesa II, pika 2.1 e pika 3⁶, e saj, atëherë, për të njëjtin objekt (një pjesë të tij) nuk mund t'i refuzohet lidhja me energji elektrike për abonent jo familjar, me motivin e mësipërm.

Me arsyetimin sa më sipër, bie poshtë edhe pretendimi tjetër i ERE-s dhe OSSH sha, se ky dokumentacion është i domosdoshëm për përcaktimin e kufijve të pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.

De facto, kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit janë të përcaktuara, pasi, në objektin e ankuesit, OSSH sha ka instaluar prej kohësh matësin e energjisë elektrike (siç duket edhe nga fotot e depozituara nga ankuesi), i montuar, fiksuar e vulosur nga OSSH sha, i gatshëm për të furnizuar objektin, pas formalizimit të kontratës me abonentin.

Nga ana tjetër, Komisioneri, analizon kuptimin e “*kufijve të pronësisë*” sipas përcaktimit që i bën ligji nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar dhe “*Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes*”.

Neni 27⁷, pika 3, e Ligjit “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar, përcakton se:

“ERE miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licencuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe efçente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.”

“*Kodi i Funksionimit të Shpërndarjes*” (Kodi i Shpërndarjes) është pjesë e akteve nën-ligjore të Ligjit “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, i ndryshuar.

“*Kodi i Shpërndarjes*” është një përmbledhje rregullash, normash, procedurash dhe kërkesash teknike për pjesmarresit në Tregun e Energjisë Elektrike në Shqipëri. Qëllimi i “Kodit të Shpërndarjes” është të promovojë dhe të vendosë rregullat dhe kërkesat teknike minimale për lidhjen në rrjet dhe mbajtjen e stabilitetit, sigurisë dhe qëndrueshmerisë së rrjetit, të detyrueshme këto për Kompaninë/të e Shpërndarjes dhe përdoruesit e lidhur në rrjetin elektrik të shpërndarjes. Kodi i Shpërndarjes miratohet nga ERE, me propozim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij⁸.

⁶ Vërtetim i pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si: Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi).

⁷Lidhja me rrjetin

⁸ Pika 2, e nenit 73, të ligjit nr. 43/2015 “*Për sektorin e energji elektrike*”, të ndryshuar.

Qëllimi i këtij Kodi, sipas përcaktimit të pikës IV.1, të tij, është, që ndër të tjera, të përmbushë objektivat e mëposhtme:

1. *Gjithë Përdoruesit ekzistues të Sistemit të Shpërndarjes ose ata të Perspektivës trajtohen në mënyrë të barabartë.*
2. *Çdo Lidhje e Re nuk duhet të shkaktojë ndonjë efekt negativ tek Përdoruesit ekzistues, ose një Lidhje e Re nuk duhet të ndikohet nga efektet negative të Përdoruesve ekzistues.”*

Në pikën IV.2.2.1, të Kodit, përcaktohet se: “Për lidhje në tension të ulët, OSSH kërkon informacionin e mëposhtëm:

- *“Emri i objektit (vendi i konsumit);*
- *Vendosja ((Percaktimi/Vendndodhja) e objektit, adresa. Bashkëngjit një hartë të vendndodhjes në zonën respektive nëse kërkohej nga KSH;*
- *Specifika e aktivitetit (prodhimi, tregtimi, shërbimet, etj)*
- *Lloji i lidhjes së kërkuar (një fazore ose tre fazore);*
- *Fuqinë e instaluar në Kw;*
- *Projektin elektrik të instalimeve të Përdoruesit, të bërë nga Inxhinier elektrik të licensuar;*
- *Deklaratë mbi konformitetin e instalimeve të brendshme të Përdoruesit;*
- *Kërkesat për Kw ose KVA maksimale;*
- *Kërkesën vjetore për Energji Elektrike në Kw/orë;*
- *Tipi dhe ngarkesa elektrike e pajisjes që do lidhet, (si numri dhe fuqia e motorëve, ndricimi, etj.)*
- *Faktori mesatar i fuqisë, me të cilin do të punojë konsumatori;*
- *Data kur kërkohej lidhja.*
- *Nëse vlerësimi paraprak i këtyre të dhënave tregon se kërkohej më shumë informacion i detajuar, atëherë ai do të sigurohet nga Përdoruesi/Konsumatori respektiv, Kompanisë(ve) të Shpërndarjes, sipas kërkesës.”*

Në pikën 4.5, të Kodit, “Kufijte e Pronësive” (Kufijte mes Sistemit të Shpërndarjes dhe Pajisjeve në pronësi të Përdoruesit), parashikohet si më poshtë vijon:

“Pika ose pikat në të cilat energjia tërhiqet ose injektohet mes Sistemit të Shpërndarjes dhe instalimit të Përdoruesit do të vendoset nga Kompania/të e Shpërndarjes dhe Përdoruesi sipas kërkesës.

Kufijtë e pronësive do të caktohen në Marrëveshjen e Lidhjes ose Marrëveshjen e Furnizimit me qëllim që:

- *të lehtësojnë veprimet e mirëmbajtjes së Kompanisë/ve të Shpërndarjes;*
- *të minimizojnë shqetësimet e Përdoruesit të Sistemit të Shpërndarjes nga Kompania/të e Shpërndarjes dhe detyrat e përditshme të Furnizuesit;*

- të lehtësojnë leximet e matësve komercialë dhe transmetimin e të dhënave;
- të mundësojnë shkëputjen dhe rilidhjen e pajisjeve në rrjet.

Për furnizimet me tension të ulët përgjegjësia e Kompanisë/ve të Shpërndarjes shtrihet deri në Pikën e Lidhjes së Klientit.

Për furnizimet me Tension të Lartë kufijtë e pronësisë do të jenë në çdo rast objekt i marrëveshjeve specifike mes palëve. Ndryshimet në marrëveshjet e Kufijve të propozuara nga secila palë do të vendosen paraprakisht.

Gjithë pajisjet në Kufijtë e Pronësisë do të plotësojnë parimet e planifikimit që përmbahen në Kapitullin e Planifikimit. Lidhjet e Përdoruesve me Sistemi i Shpërndarjes do të përfshijnë mjete të shkëputjes së instalimit të Përdoruesit nga Sistemi i Shpërndarjes.

Marrëveshjet e Mbrojtjes së Përdoruesit të Sistemit të Shpërndarjes në Kufijtë e Pronësisë, përfshirë tipet e Pajisjes dhe pajisjet e Mbrojtjes, do të përputhen me kushtet ekzistuese të Sistemit të Shpërndarjes dhe praktikat e mbrojtjes së Sistemit të Shpërndarjes siç specifikohet nga Kompania/të e Shpërndarjes në kohen e aplikimit.”

Nisur nga përcaktimet e mësipërme, që vetë Kodi i bën kufijve të pronësisë, qartazi evidentohet se, nuk ka asnjë lidhje qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë të tërthortë mes nocionit të pronësisë, të përcaktuar nga “Kodi i Shpërndarjes” dhe korrelacionit që i bën ERE dhe OSSH sha, këtij nocioni me pronësinë e objektit të ankuesit. (mungesën e titullit të pronësisë mbi banesën/objektin)

Komisioneri vëren se, pretendimi i ERE-s, se pronësia si element thelbësor...është prekuizitë e ligjit, e jo vetëm e akteve të miratuara prej saj, rezulton e pabazuar për këto arsye:

- Në asnjë dispozitë të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nuk përmendet koncepti i pronësisë si një element thelbësor për lidhjen e kontratës me furnizim me energji elektrike.
- Në nenin 3, të ligjit sipërcituar, jepen përkufizime e kuptime për 93 (nëntëdhjetë e tre) terma të ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, në të cilat nuk përfshihet dhe përkufizohet termi i pronësisë.
- Qëllimi i Ligjit, sipas nenit 1, është: “Garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit. “
- Objekti I Ligjit, sipas nenit 2, është: “Ky ligj rregullon marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat lidhur me:

- a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
- ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
- d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.”

Pretendimi i ERE-s, nga ana tjetër është kontradiktor, pasi, nëse pronësia është element thelbësor për lidhjen e kontratës me energji elektrike atëherë asnjë nga qindra mijëra abonentë me ndërtime informale (pra, që s’kanë dokumenta pronësie) të kundërligjshme, nuk duhej t’u ishte lidhur kontrata për furnizimin me energji elektrike.

Koncepti i kufijve të pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit, (sipas nenit 27, pika 3, e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar) nuk është automatikisht sipas konceptit të Kodit Civil të pronësisë të patundshme (objekte, ndërtesa, etj), por është pronësia mbi rrjetin e lidhjes e energji elektrike dhe kufirin se ku përfundon rrjeti i energjisë elektrike i operatorit (OSSHE) dhe ku fillon rrjeti i energjisë së përdoruesit (deri në shtrimin e rrjetit brenda objektit të përdoruesit), çka përfshin kufirin ndarës të rrjetit.

Nga ana tjetër, ERE dhe OSSH sha, duke i qëndruar strikt Rregullores për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes, (por jo frymës së ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, dhe të vetë “Rregullores”), pranon si dokumentacion për lidhjen e kontratës për furnizim me energji elektrike familjar e jo familjar, mijëra e mijëra abonentë që kanë ndërtimet/objektet në process legalizimi (dhe me të drejtë), që kanë ndërtuar në mënyrë të kundërligjshme, në tokë të vet, në tokat e të tjerëve, apo në troje publike, kanë shtuar e ndryshuar struktura ndërtimore

Nga ana tjetër, jo të gjitha ndërtimet informale janë apo mund të legalizohen sipas kriterëve të ligjit.

Përveç arsyeve të mësipërme, ERE dhe OSSH sha refuzojnë lidhjen e kontratës së energjisë elektrike për ankuesin, i cili:

- Është përdorues në kushtet e mirëbesimit dhe banon në një objekt (në pronësi të shtetit, me leje ndërtimi, i ndërtuar para viteve 1990 - objektet e ish SMT-së), dhe ka kontratë të rregullt për furnizimin me energji elektrike për abonent familjar, si dhe furnizim me ujë.
- Në këtë rast, diskutohet nëse, pronësia e objektit, të cilin ankuesi e posedon dhe përdor me mirëbesim prej 27 vitesh, do të mbetet në pronësi shtetërore apo do t’i privatizohet ankuesit.

Pretendimi i ERE-s dhe OSSH sha, se objekti nuk është në proces privatizimi, nuk rezulton i bazuar për këto shkaqe:

- Së pari, Me Vendimin nr. 36, datë 21.07.1995, të Komisionit të Kthimit, Kompensimit të Pronave (KKKP) Burrel, kërkuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë, i është njohur pronësia e truallit si ish-pronar dhe e drejta e parablerjes së objektit ku banon prej 27 vitesh (ish SMT). Sipas doktrinës juridike dhe jurisprudencës gjyqësore, e drejta e parablerjes për ish - pronarët, është një e drejtë reale dhe që gëzon mbrojtje ligjore.
- Së dyti, me shkresën me nr. 2932 prot., datë 11.02.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Shtetërore, drejtuar Ministrit të Financave, Përgjegjësit të Degës së Shoqërive Publike, si dhe ankuesi P. H, **njoftohet se është miratuar fillimi i procedurës së privatizimit për objektin “Ish zyrat e SMT-së Burrel”.**

Në ndryshim nga sa pretendojnë ERE dhe OSSH sha, nuk rezulton të ketë ndonjë akt administrativ që të ketë anuluar, shfuqizuar, ndryshuar aktin sipërcituar të Drejtorisë së Privatizimit (me të cilin është miratuar fillimi i procedurës së privatizimit), duke e nxjerrë objektin jashtë procesit të privatizimit.

Fakti se ankuesi sipër vërtetimit të datës 06.02.2024, ka kërkuar me cilësinë e paditësit (që prej datës 16.12.2022) detyrimin e Ministrisë së Financave, Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, Dega e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, që të vazhdojnë procesin e privatizimit, për objektin ish zyrat e SMT-së Burrel, edhe për arsyet e shpjeguara më sipër, nuk do të thotë që, procesi i privatizimit të objektit është zhbërë, anuluar, përderisa nuk ka ndonjë akt administrativ që, shprehimisht, objektin ku qëndron ankuesi, ta ketë nxjerrë, përjashtuar nga procesi i privatizimit.

Objekti vazhdon të jetë në proces privatizimi, pavarësisht kohëzgjatjes, për arsye teknike, objektive apo subjektive, zvarritjeve burokratike apo edhe konfliktit gjyqësor të iniciuar nga ankuesi.

Nga analizimi i dispozitave ligjore sipërcituar, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues është vënë në pozita të pafavorshme dhe është trajtuar në mënyrë të padrejtë nga ana e ERE-s dhe OSSH sha, përse i takon refuzimit nga ana e tyre (ERE nëpërmjet qëndrimit udhëzues në mënyrë të drejtëpërdrejtë kundrejt OSSH sha) të kërkesës së shtetasit P. H, për të lidhur kontratë për furnizim me energji elektrike për abonent jofamiljar, për fuqinë 6 Kw.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁹, të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

B.1 Çdo shkak tjetër

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹⁰. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i LMD-së është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh¹¹.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

⁹ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

¹⁰ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

¹¹ Neni 14, i KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferenca që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.¹² Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.¹³ Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”¹⁴.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit i *burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar* (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Një nga përkufizimet e cituara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDN), është “*veçoria personale*” në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes njëri-tjetrit. Sipas GJEDNJ, shkaku i diskriminimit është individual, karakteristik për një individ, dhe

¹² Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

¹³ Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

¹⁴ Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara¹⁵.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në frymën e saj dhe në veçanti, në nenin 25 të saj shprehet se, e drejta për energji elektrike në vetvehte është një e drejtë themelore e njeriut që buron nga e drejta për një standard të përshtatshëm jetese.

Krijimi i mundësisë për t'u furnizuar me energji elektrike ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë e jetesës së individit. Në këtë këndvështrim, ankuesi ka kërkuar furnizim me energji elektrike në funksion të ushtrimit të aktivitetit të tij privat, për sigurimin e të ardhurave të tij familjare.

Aksesi në burimet kryesore të jetës është një nevojë humane thelbësore dhe për rrjedhojë dhe një e drejtë elementare për t'u respektuar. Mungesa e aksesit të plotë në këto burime është një goditje në dinjitetin e individit për sigurimin e jetesës së tij nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit, biznesit të tij privat.

Komisioneri, në arsyetimin e tij, në pjesën III/A, të Vendimit, vlerëson se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, sa i takon refuzimit të miratimit të lidhjes së re të enrgjisë elektrike, me fuqi 6 Kw, për konsumator jo familjar. Duke i pamundësuar kështu dhe të drejtën e ushtrimit të aktivitetit, biznesit të tij privat me qëllim përmirësimin e të ardhurave financiare.

Referuar akteve shkresore të depozituara nga palët në process, si dhe qëndrimit të mbajtur prej tyre, gjatë seancës dëgjimore por edhe në deklaratimet në vijim të saj, rezulton se ERE dhe OSSH sha, kanë pranuar faktin që ankuesit, i është refuzuar miratimi i lidhjes së re, pikërisht për shkak të mungesës së dokumentimit: “Vërtetim të pronësisë së objektit nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë si: Akt shitje, akt dhurimi, akt ndarje prone të patundshme, kontratë qiraje, dokumentacioni përkatës për objektet që janë në proces legalizimi, si ekuivalent për miratimin e lidhjes së re”¹⁶.

ERE dhe OSSH sha, kanë cilësuar pikërisht “...mungesën e dokumentimit të pronësisë/vërtetimit të pronësisë nëpërmjet dokumentave të regjistrimit të pronësisë”, të ankuesit, duke e përdorur njëherësh si motivacion dhe arsye për refuzimin e miratimit të kërkesës për lidhje të re, si konsumator jo familjar.

Ata shprehen në mënyrë kontradiktore se:

- Nga njëra anë, se “qenia në proces privatizimi nuk është e parashikuar literalisht në dokumentacionin e kërkuar sipas “Rregullores së Lidhjeve të Reja në Rrjetin e Shpërndarjes”, të miratuar nga ERE.”;

¹⁵ Handbook on European Non-discrimination Law’. EU FRA and CoE, 2010.97

¹⁶ Shkresa me nr. 967/3 prot., datë 03.06.2024, e ERE-s, (qëndrim i përsëritur në vijimësi) dhe në komunikimin me KMD-në)

- Nga ana tjetër se, ankuesi nuk dokumenton faktin se është në proces privatizimi, pasi nëse do të provonte këtë fakt, do të njihej si dokument i vlefshëm në kuadër të provueshmërisë së titullit të pronësisë;
- Ankuesi duhet të disponojë një vendim gjyqësor të formës së prerë, lidhur me procesin e privatizimit të objektit – kërkuar gjyqësisht prej tij.

Ndërkaq, lidhur me sa më sipër, Komisioneri në arsyetimin e tij (faqe 14-15, e vendimit) ka vlerësuar se, ankuesi nëpërmjet dokumentacionit të depozituar ka provuar se ndodhet në proces privatizimi të objektit të tij (Drejtoria e Përgjithshme e Pronës Shtetërore me shkresën me nr. 1932 prot., datë 11.02.2017, ka miratuar fillimin e procedurës së privatizimit të objektit ish-SMT Burrel- objekt që posedohet nga ankuesi), dhe se ky fakt (kalimi i titullit të pronësisë mbi objektin-objekt privatizimi, nëpërmjet procesit gjyqësor) duhet pranuar e njohur si *dokumentacion i vlefshëm*, për analogji edhe me dokumentacionin e kërkuar në rastet kur abonentët apo kërkuarët, janë në proces legalizimi për objektet e tyre (për të cilat kërkohej furnizimi me energji elektrike), pa e lidhur domosdoshmërisht me faktin nëse, në përfundim të këtij procesi, objekti do të legalizohet ose jo.

Në këtë kontekst, bazuar në sa më sipër, Komisioneri ka vlerësuar se ankuesi ka provuar se ndodhet në proces privatizimi të banesës së tij, dhe këtë “cilësi” të tij e vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, të subjektit ankues me “çdo shkak tjetër”¹⁷.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e ERE-s dhe OSSH sha, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të “çdo shkak tjetër”¹⁸, të qenies në proces privatizimi të objektit të poseduar në mirëbesim prej 27 vitesh, prej tij.

Në kontekst të legjitimitetit të subjekteve ERE dhe OSSH sha, kundrejt të cilëve ankuesi ka paraqitur pretendimet e tij, Komisioneri vlerëson se, referuar dispozitave të mëposhtme ligjore, ata gëzojnë legjitimitet pasiv në këtë proces administrativ, duke cituar si më poshtë vijon:

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është autoriteti rregullator i sektorit të energjise elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

¹⁷ Referuar nën ndarjes B/2 të Vendimit.

¹⁸ Bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, bazuar në statusin e veçantë ligjor që gëzon subjekti ankues, si posedues i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë, Komisioneri i vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër”.

ERE mbikëqyr dhe rregullon sektorin e energjisë në Shqipëri me kompetencat kryesore si vijon:

- Lëshon dhe monitoron licencat për operatorët e energjisë (energji elektrike, gaz, bunitet e rinovueshme);
- Zhvillon rregullat e tregut, siguron konkurrencën dhe promovon liberalizimin e tregut;
- Miraton tarifat për shërbimet e rregulluara dhe siguron çmime që reflektojnë koston;
- Mbron të drejtat e konsumatorëve, zgjidh mosmarrëveshjet dhe promovon transparencën;
- Miraton planet e investimeve dhe siguron besueshmërinë e sistemit energjetik;
- Mbeshtet integritetin dhe nxitjen e burimeve të rinovueshme;
- Harton dhe miraton kuadrin rregullator në përputhje me standardet e BE-së;
- Punon me organet rajonale dhe të BE-së për politikën energjetike;
- Gjurmë performancën e tregut dhe raporton mbi zhvillimet e sektorit;
- ERE siguron një sektor energjie transparent, efikas dhe të qëndrueshëm në Shqipëri.

Neni 24, “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga ERE”, përcakton se:

“1. ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave.

2. Çdo palë e interesuar, që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t'i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s. ERE merr vendim brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera, në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

3. ERE mund të vendosë mospranimin e ankesës nëse, bazuar në legjislacionin në fuqi, konstaton se shqyrtimi i ankesës nuk është kompetencë e saj.

4. Paraqitja e ankesës, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk i heq të drejtën palës së interesuar për t'u drejtuar pranë organeve të tjera kompetente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, OSSH, është personi juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar, dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe efikasitetin e energjisë. Për sa më sipër, OSSH shpall, në zbatim të legjislacionit në fuqi, shqyrton e vlerëson aplikimet për lidhjet e reja, e po mbi përgjegjësinë e ngarkuar në cilësinë e operatorit të rrjetit, miraton apo refuzon çdo aplikim që plotëson apo nuk plotëson kriteret e miratuara në këto akte¹⁹.

¹⁹ Referuar shkresës me nr. 967/10 prot., datë 27.11.2024, të ERE-s.

Neni 68, “Shpërndarja e energjisë elektrike”, i ligjit nr. 43/2015 “Per Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar përcakton se:

“1. Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në pikën 2, të nenit 54, të këtij ligji.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:

a) sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;

b) përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike,

c) mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes respekton treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.

5. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike zhvillohet mbi parimin e kostos më të ulët, në përputhje me legjislacionin mbi planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe përdorimin me eficientë të energjisë.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve teknologjike. Në varësi të mundësive, pjesë të infrastrukturës së komunikimeve dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e veta brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.”

Neni 69, “Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, i Ligjit, përcakton se:

“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

a) operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;

b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimet e kërkesës për shpërndarjen e energjisë elektrike;

b/1) bën mirëmbajtjen dhe riparimin periodik ose sipas nevojës së rastit të kabinave elektrike, të cilat janë në bashkëpronësi, apo në pronësi të të tretëve. Përgjegjës vetë për mirëmbajtjen dhe riparimin e kabinave elektrike, klientët jofamiljarë privatë që shprehin vullnetin për kryerjen vetë të mirëmbajtjes dhe riparimit, si dhe kur kabina elektrike është me një përdorues.

c) lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi;

ç) siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

d) u siguron përdoruesve të rrjetit informacionin për akses dhe përdorim të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes;

dh) mbledh dhe paraqet tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhënat e nevojshme për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj, rregullat e tregut dhe rregullat për ndryshimin e furnizuesit;

e) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

ë) prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me procedura transparente jodiskriminuese. Procedurat e prokurimit të energjisë elektrike miratohen nga ERE, pas propozimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

f) harton profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme;

g) mban evidencën e shoqërive të licencuara që furnizojnë me energji elektrike, në të gjitha pikat e lidhjes dhe pikat e matjes së rrjetit respektiv shpërndarës;

gj) i siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike, akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi. ERE përcakton formatin e të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj këtyre të dhënave;

h) ofron shërbime të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve, sipas këtij neni.”

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një arsye e përligjur dhe objektive për trajtimin ndryshe të rastit të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor²⁰.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

²⁰Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në pikën 25, të Komentit të Përgjithshëm Nr. 20, është shprehur se: *“Statusi i pronës, si një bazë e ndaluar e diskriminimit, është një koncept i gjerë dhe përfshin pronën e patundshme (p.sh. pronësia ose zotërimi i tokës) dhe pasuria personale (p.sh. pronësia intelektuale, mallrat dhe sendet dhe të ardhurat), ose mungesa e saj.*

...të drejtat e parashikuara në Konventë (KEDNJ), si: qasja në shërbimet e ujit, energjisë elektrike dhe mbrojtja nga dëbimi i detyruar, nuk duhet të kushtëzohen me statusin e një personi mbi pronësinë ose zotërimin e tokës, siç është jetesa në një vendbanim informal.”

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivist të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Neni 20, në pikat 1, shkronja a) dhe pika 4, e LMD-së, parashikon se:

“ 1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

.... a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²¹ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.*

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime *“...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha*

²¹ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë

dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara²²”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse institucionet respektive, ERE dhe OSSH sha, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jenë respektivisht përgjegjëse për diskriminimin.²³

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e ERE-s dhe OSSH sha, lidhur me mosveprime të tyre kundrejt ankuesit, dhe si pasojë barra e provës bie tek këto dy subjekte. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, ERE dhe OSSH sha, duhet të përmbushnin njërin nga dy kushtet e përmendura më sipër.

²² GjEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147.

GjEDNJ,

Timishev v. Rusisë (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GjEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës*

Çeke [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

²³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se subjektit ankues, është posedues në mirëbesim prej 27 vitesh, i objektit, banesës ku jeton, dhe se është në proces gjyqësor me objekt vazhdimin e procesit të privatizimit të objektit të tij. Në këto kushte, ai aktualisht nuk disponon një titull pronësie mbi objektin në fjalë, dhe, pikërisht për shkak të mungesës së tij, (dhe pavarësisht faktit se është në proces privatizimi) ankuesi është vënë në pozita të pafavorshme, si nga ana e ERE-s dhe e OSSH sha, duke i refuzuar lidhjen e re për furnizimin me energji elektrike si abonent, konsumator jofamiljar.

Njëkohësisht sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar pretendimi i ankuesit se, shkak për trajtimin e tij të padrejtë e të pafavorshëm është bërë pikërisht mospasja e titullit të pronësisë mbi objektin, dhe njëherësh mosnjohja e qënies së tij në proces privatizimi nga ana e ERE-s dhe OSSH sha, duke e lidhur kërkimin e tij gjyqësor për këtë fakt, me vendimarrjen e formës së prerë nga ana e Gjykatës. Sa më sipër, është pranuar nga ana e ERE-s dhe OSSH sha, se pikërisht ai është shkak dhe motivi për refuzimin e lidhjes së re të kërkuar nga subjekti ankues.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga procedura hetimore, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues e mbart shkakun e sipërpërmendur.

Në rastin konkret pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se mosveprimi i institucioneve përgjegjëse, ka ardhur për shkak të pengesave dhe refuzimit që ata i kanë bërë ankuesit, si posedues i banesës, për shkak të mungesës së titullit të pronësisë apo një dokumenti të vlefshëm pronësie *(duke arsyetuar se: ...në kushtet e ekzistencës së një hetimi gjyqësor me qëllim përcaktimin e titullit të pronësisë mbi objektin, objekt privatizimi, për të patur legjitimitet aktiv duhet më parë të lejojë Gjykatën të shprehet me vendim përfundimtar...²⁴)*, gjë që ka pasuar me refuzimin e kërkesës së tij për lidhje të re për furnizim me energji elektrike, si abonent, konsumator jofamiljar.

Nga ana e këtyre institucioneve janë parashtruar para Komisionerit si argumenta se, ankuesi duhet të depozitojë dokumentacionin e nevojshëm e të vlefshëm të pronësisë, dhe pastaj mund të vijohet me procedurën e mëtejshme për të realizuar me të, lidhjen e re si abonent jofamiljar dhe furnizimin e objektit në fjalë me energji elektrike.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, argumenti i përdorur nga insitucionet përgjegjëse, për mosveprimin e tyre, është i pajustificuar, i padrejtë, jo objektiv, si dhe në kundërshtim me të drejtat ligjore të ankuesit për akses në furnizimin me energji elektrike si abonent/konsumator jofamiljar, që passjell dhe mohimin e të drejtës së tij për ushtrim të aktivitetit privat.

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të

²⁴ Shkresa me nr. 967/10 prot., datë 27.11.2024, e ERE-s.

provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ERE dhe OSSH sha, nuk arritën të argumentojnë ligjërisht dhe të provojnë me dokumentacion apo prova të tjera që subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, përse i takon refuzimit të lidhjes së re për furnizimin me energji elektrike me të, si abonent/konsumator jofamiljar, për objektin ku do të ushtrojë aktivitetin privat. Ata kanë pohuar e dëshmuar se shkak për këtë refuzim është bërë mospasja nga ana e ankuesit e një dokumenti të vlefshëm të titullit të pronësisë për objektin në fjalë, dokumentacion që sipas tyre, është i domosdoshëm për përcaktimin e kufijve të pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.

Pra në analizë të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, ERE dhe OSSH sha, nuk kanë provuar se, dokumentacioni i kërkuar prej tyre (*vërtetim i titullit të pronësisë apo vendimi i formës së prerë të Gjykatës lidhur me përfundimin e procesit gjyqësor që lidhet me objektin e kërkuar nga ankuesi, privatizimin e objektit në fjalë*), është thelbësor dhe i domosdoshëm për përcaktimin e kufijve të pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit, sikurse ata kanë pretenduar.

Komisioneri ka arsyetuar se, *de facto*, kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit janë të përcaktuara, pasi, në objektin e ankuesit, OSSH sha ka instaluar prej kohësh matësin e energjisë elektrike;

Nga ana tjetër, në analizën e kuptimit të termit të “*kufijve të pronësisë*”, nisur nga përcaktimet që legjislacioni i analizuar më sipër, i bën kufijve të pronësisë, Komisioneri vlerëson se, nuk ka asnjë lidhje qoftë të drejtpërdrejtë, qoftë të tërthortë mes nocionit të pronësisë, të përcaktuar nga “Kodi i Shpërndarjes” dhe korrelacionit që i bën ERE dhe OSSH sha, këtij nocioni me pronësinë e objektit të ankuesit. (mungesën e titullit të pronësisë mbi banesën/objektin)

Komisioneri vëren se, pretendimi i ERE-s, se pronësia si element thelbësor...është prekuizitë e ligjit, e jo vetëm e akteve të miratuara prej saj, rezulton e pabazuar, pasi në asnjë dispozitë të ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, të ndryshuar, nuk përmendet koncepti i pronësisë si një element thelbësor për lidhjen e kontratës me furnizim me energji elektrike.

Koncepti i kufijve të pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit, (*sipas nenit 27, pika 3, e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar*) nuk është automatikisht sipas konceptit të Kodit Civil të pronësisë të patundshme (objekte, ndërtesa, etj), por është pronësia mbi rrjetin e lidhjes e energji elektrike dhe kufirin se ku përfundon rrjeti i energjisë elektrike i operatorit (OSSHE) dhe ku fillon rrjeti i energjisë së përdoruesit (deri në shtrimin e rrjetit brenda objektit të përdoruesit), çka përfshin kufirin ndarës të rrjetit.

Komisioneri vlerëson se, ankuesi është përdorues në kushtet e mirëbesimit dhe banon në një objekt (në pronësi të shtetit, ndërtuar para viteve 1990, objektet e ish SMT-së), me kontratë të

rregullt për furnizimin me energji elektrike për abonent familjar, si dhe furnizim me ujë. Në rastin në fjalë, diskutohet nëse, pronësia e objektit, të cilin ankuesi e posedon dhe përdor me mirëbesim prej 27 vitesh, do të mbetet në pronësi shtetërore apo do t'i privatizohet ankuesit.

Komisioneri konstaton se, pretendimi i ERE-s dhe OSSH sha, se objekti nuk është në proces privatizimi, rezulton i pabazuar për këto arsye:

- Me Vendimin nr. 36, datë 21.07.1995, të Komisionit të Kthimit, Kompensimit të Pronave (KKKP) Burrel, kërkuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë, i është njohur pronësia e truallit si ish-pronar dhe e drejta e parablerjes së objektit ku banon prej 27 vitesh (ish SMT). Sipas doktrinës juridike dhe jurisprudencës gjyqësore, e drejta; e parablerjes për ish pronarët, është një e drejtë reale dhe që gëzon mbrojtje ligjore.
- Me shkresën me nr. 2932 prot., datë 11.02.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Shtetërore, drejtuar Ministrit të Financave, Përgjegjësit të Degës së Shoqërive Publike, si dhe ankuesi P.H, **njoftohet se është miratuar fillimi i procedurës së privatizimit për objektin “Ish zyrat e SMT-së Burrel”.**
- Në ndryshim nga sa pretendojnë ERE dhe OSSH sha, **nuk rezulton të ketë ndonjë akt administrativ që të ketë anuluar, shfuqizuar, ndryshuar aktin sipërcituar të Drejtorisë së Privatizimit (me të cilin është miratuar fillimi i procedurës së privatizimit), duke e nxjerrë objektin jashtë procesit të privatizimit.**
- Fakti se ankuesi sipër vërtetimit të datës 06.02.2024, ka kërkuar me cilësinë e paditësit (që prej datës 16.12.2022) detyrimin e Ministrisë së Financave, Drejtrinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, Dega e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, që të vazhdojnë procesin e privatizimit, për objektin Ish zyrat e SMT-së Burrel, edhe për arsyet e shpjeguara më sipër, nuk do të thotë që, procesi i privatizimit të objektit është zhbërë, anuluar, përderisa nuk ka ndonjë akt administrativ që, shprehimisht, objektin ku qëndron ankuesi, ta ketë nxjerrë, përjashtuar nga procesi i privatizimit.
- Objekti vazhdon të jetë në proces privatizimi, pavarësisht kohëzgjatjes, për arsye teknike, objektive apo subjektive, zvarritjeve burokratike apo edhe konfliktit gjyqësor të iniciuar nga ankuesi.

Neni 22, shkronjat c), d) dhe dh), të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, përcaktojnë ndër të tjera se, ERE monitoron:

“...c) efektivitetin e konkurrencës së tregut në nivel shitjeje me shumicë dhe pakicë, shkëmbimet, rregullat e ndryshimit të furnizuesit, rregullat e shkëputjes nga rrjeti, pagesat e shërbimeve të mirëmbajtjes, ankesat e klientëve dhe çdo shtrembërim apo kufizim të konkurrencës, duke informuar Autoritetin e Konkurrencës për rastet e konstatuara;

....

d) afatet brenda të cilave operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes përfundojnë lidhjen në rrjet të klientëve të rinj apo kryejnë riparimet në rrjete;

dh) zbatimin e rregullave lidhur me rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, furnizuesve, klientëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut.”

Nisur nga përgjegjësitë dhe kompetencat e ERE-s, deklaratimet dhe qëndrimin e mbajtur para Komisionerit sa i takon shqyrtimit të ankesës së z. H (po ashtu dhe në korrespondencën e mbajtur me subjektin ankues) si dhe arsytimit të saj se, OSSH sha ka vepruar drejt që ka refuzuar lidhjen e re për furnizim me energji elektrike për konsumator jofamiljar me ankuesin, për objektin në fjalë, pasi nëse do të vepronte ndryshe ajo do të kryente shkelje dhe ndaj saj ERE do të ishte objekt sanksioni e ERE-s²⁵. Komisioneri vlerëson se, të gjitha këto janë veprime që dëshmojnë se refuzimi i lidhjes së re me ankuesin, është bërë me orientimin e udhëzimin e ERE-s.

Përsa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke parë në vijim veprimet e ndërmarra nga OSSH sha, krijon dyshimin e arsyeshem që kemi të bëjmë me diskriminim në formën e “udhëzimit për të diskriminuar”, parashikuar në nenin 3, pika 15, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar ku citohet se:

....

15. “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.”

Krahas kësaj, të gjitha direktivat për mosdiskriminim thonë se “udhëzimi për diskriminim” çmohet të përbëjë “diskriminim”²⁶.

Për të pasur një rast prima facie të thirrjes, nxitjes dhe udhëzimeve për diskriminim, parashtruesi ose parashtruesja e parashtrësës duhet të tregojë:

- aktivitet me të cilin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë bëhen thirrje, inkurajohen, artikulojnë udhëzime ose nxitje që të kryhet diskriminim,
- ekzistim të shkakut apo shkaqeve diskriminuese.

Udhëzimi për diskriminim e nënkupton thirrjen, inkurajimin, udhëzimin ose nxitjen e një personi tjetër për kryer diskriminim, si në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu dhe të tërthortë.

²⁵ Referuar deklaratimeve të përfaqësueses së ERE-s në seancën dëgjimore, datë 18.02.2025, minuta 0:44:53 e saj.

²⁶ Neni 2(4), Direktiva për Barazinë në Punësim; Neni 4(1), Direktiva e trajtimit të Barabartë Gjinor në lidhje me aksesin dhe ofrimin e Mallrave dhe Shërbimeve; Neni 2(2)(b), Direktiva për Barazinë Gjinore (e rishikuar); Neni 2(4), Direktiva për Barazinë Raciale.

“Udhëzim për të diskriminuar” si formë diskriminimi është trajtuar edhe nga GJEDNJ. Në çështjen *Bączkowski dhe të tjerët kundër Polonisë* (*Bączkoëski and others v. Poland*), kryetari i Bashkisë së Varshavës bëri deklaratë publike me natyrë homofobike ku thoshte se do të refuzonte lejimin e një marshimi për rritjen e ndërgjegjësimit për diskriminimin për shkak të orientimit seksual.²⁷ Kur vendimi ishte përpara organit administrativ përkatës, leja u refuzua për arsye të tjera, të tilla si nevoja për parandalimin e përplasjeve ndërmjet demonstruesve.

Në këtë rast, GJEDNJ konsideron se në vlerësimin e çështjes nuk mund të mos pranojë mendimet e forta personale të shprehura publikisht nga kryetari i bashkisë për çështje që lidhen drejtpërdrejtë me vendimet në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit. Ajo vëren se vendimet në fjalë u morën nga autoritetet komunale që vepronin në emër të kryetarit pasi ai i bëri të njohur opinionet e tij në lidhje me ushtrimin e lirisë së tubimit...²⁸.

Sipas GJEDNJ, mund të supozohet në mënyrë të arsyeshme që mendimet e kryetarit të bashkisë së Varshavës mund të kenë ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe si pasojë të shkelnin në mënyrë diskriminuese të drejtën e aplikantëve për lirinë e mbledhjes dhe kjo përbënte një shkelje të nenit 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 11, për shkak të orientimit seksual.

Në këtë kuptim, sipas vlerësimit të GJEDNJ *“udhëzimi për diskriminim”*, nuk kufizohet thjeshtë me udhëzimet që janë detyruese në natyrë, por zgjerohet duke përfshirë situata ku ekziston një preferencë e shprehur në mënyrë direkte apo indirekte ose një inkurajim për të trajtuar individët në mënyrë më pak të favorshme.

Raste të tjera ku gjykatat kanë vlerësuar si diskriminim në formën e *“udhëzimit për të diskriminuar”* gjejmë si në praktikën e GJEDNJ, ashtu edhe te gjykatave vendase (kombëtare)²⁹.

Bazuar sa më sipër, Komisioneri gjykon se marrja pjesë aktive në procedurën për trajtimin e ankesës së subjektit ankues, deklaratimet dhe qëndrimi i mbajtur nga ERE (si më sipër cituar), ka ndikuar në veprimet e ndërmarra nga ana e OSSH sha (*i cili ka tagrin për lidhjen apo refuzimin e lidhjeve të reja në rrjet*) për refuzimin e lidhjes së re për furnizim me energji elektrike për z. H, si abonent jofamiljar për objektin në fjalë.

Së fundmi, duke analizuar gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesit i është cënuar dhe e drejta e ushtrimit të aktivitetit privat, duke i mohuar aksesin në furnizimin me energji elektrike të objektit të poseduar prej tij (*për të cilin është në proces gjyqësor për privatizimin e tij*), e drejtë kjo e mbrojtur drejtpërdrejtë nga legjialacioni në fuqi.

²⁷ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discriminatory_Law_SQL.pdf fq.27

²⁸ [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-80464%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-80464%22]}) paragrafi 100

²⁹ Marrë nga *Handbook on European Non-Discrimination Law*, faqe. 34. I referohet vendimit të Gjykatës Rajonale të Sofies Nr. 164 për çështjen civile Nr. 2860/2006, 21.06. 2006.

Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e sanksionuar dhe e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime mbi çdo institucion përgjegjës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e personave/subjekteve për mbrojtjen nga diskriminimi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se ERE dhe OSSH sha, kanë diskriminuar subjektin ankues, pasi me veprimet e mosveprimet e tyre nuk kanë garantuar të drejtën ligjore që ai gëzon, përkundrazi e kanë vënë në pozita të pafavorshme duke bërë që t'i mohohet e drejta e aksesit në furnizimin me energji elektrike për objektin e tij (*për të cilin është në proces gjyqësor për privatizimin e tij*), duke i pamundësuar kështu edhe të drejtën për ushtrimin e aktivitetit privat për sigurimin e të ardhurave financiare për familjen e tij.

Për rrjedhojë institucionet e ERE-s dhe OSSH sha, kanë shkelur dispozitat e ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a, dhe pika 4 e tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, përcaktohet se: "*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*".

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktimat të diskriminimit.

Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji nuk do të ishte efektive nëse subjektet për të cilat është konstatuar se kanë shkelur dispozitat e LMD-së, nuk do të ndërmerrnin masat efektive për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimit apo mosveprimit të tyre.

LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij, duke sanksionuar se: "*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përputhje me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*".

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e refuzimit të lidhjes së re për furnizimin me energji elektrike si abonent/konsumator jofamiljar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e marrë masat për lidhjen e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 7, nenin 20, pika 1, shkronja a), e pika 4, nenin 32, shkronja a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit *në formën e udhëzimit për diskriminim*, të subjektit ankues, P. H, në fushën e të mira dhe shërbimeve, për “çdo shkak tjetër³⁰”, nga ana e Entit Rregullator të Energjisë (ERE-s).
2. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, P. H, në fushën e të mira dhe shërbimeve, për “çdo shkak tjetër³¹”, nga ana e dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh a).
3. Në referim të pikës 2, OSSH sha, të marrë masa efektive për realizimin e lidhjes së re për furnizim me energji elektrike, si abonent/konsumator jofamiljar me z. P. H, në objektin ku do të ushtrojë aktivitetin privat.
4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ERE dhe OSSH sha, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³⁰ Sipas analizës së bërë në vendim për këtë shkak.

³¹ Sipas analizës së bërë në vendim për këtë shkak.